



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
**Nr. 02-060/01-0021467-5/26 dt. 29.04.2026**  
**Mitrovicë**

02-060/01-0021467-5  
29.04.2026

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 17, pika k, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, dhe nenin 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 40, të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 29.04.2026, pasi shqyrtoi Propozim Vendimin Nr. 02-400/03-0018087/26 dt. 30.13.2026 Për subvencionimin e fëmijëve me autizëm, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0018345-7/24 dt. 20.04.2026); sjell këtë:

#### VENDIM

#### Për subvencionimin e fëmijëve me autizëm

1. MIRATOHET Vendimi për subvencionim të fëmijëve me autizëm në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi të gjithë fëmijët me autizëm të evidentuar nga qendra për Punë Sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut përkrahen financiarisht me shumë të njëhershme prej 50.00 €.
3. Të gjithë përfituesit të cilët subvencionohen nga Komuna sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të jenë të evidentuar nga Qendra për Punë Sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe të jenë të regjistruar në regjistrat civile me adresë të vendbanimit në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
4. Mjetet e lejuara sipas pikës 2, të këtij vendimi ipen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

